



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:211477

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05819241

**E.nr.1117/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit L.M. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Vildane Hamiti nga Ferizaj, kundër debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës – Spitali i Përgjithshëm Ferizaj, për pagesën e shpërblimit jubilar dhe shpenzime të procedurës, më datë 13.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.1117/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1117/23, të datës 13.10.2023, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Spitali i Përgjithshëm Ferizaj, për pagesën e shpërblimit jubilar dhe shpenzime të procedurës, në bazë të aktgjykimit 2022:211477, të datës 16.02.2023.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 13.10.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,147.80 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.1117/23, më datë 13.06.2024.**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**